



REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

MZHU konsultim publik për ndryshimet në ligjin e bashkëpronësisë

2017-05-16 15:18:00



Në kuadër të përmirësimit të legjislationit në fushën e pasurive të paluajtshme, si dhe marrë shkas nga problematikat e hasura nga qytetarët dhe bashkitë, Ministria e Zhvillimit Urban inicoi procesin e përmirësimit të ligjit nr. 10112, datë 09.04.2009, "Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit", duke synuar krijimin e lehtësirave gjatë zbatimit në praktikë të tij. Duke synuar efencën gjatë implementimit të ligjit, pjesë e fokusit të ndryshimeve janë mënyra e organizimit dhe kompetencat e organeve drejtuese, administrimi dhe menaxhimi i shërbimeve, si dhe përfshirja e disa organizmave të banimit të cilat, në momentin e konceptimit dhe draftimit të ligjit, kanë qenë të panjohura dhe të pakrijuara. Këtu përmendim administrimin e komplekseve të fshatrave të banimit, si dhe përfshirja në objektin e ligjit ndërtesat e banimit që përfshijnë edhe njësi tregtare.

Një ndryshim që sjell propozimi i këtij projektligji është edhe rregullimi i statusit ligjor që? ge?zojne? asamblete? e bashke?pronare?ve, duke bërë në këtë mënyrë që asambleja e bashkëpronarëve të fitojë statusin e personit juridik jofitimprures në momentin e regjistrimit në bashki, duke krijuar fitimin e të drejtave dhe detyrimeve në mënyrë të pavarur në raport me të tretët (administratorin, furnizuesin e shërbimeve, shfrytëzimin / dhënien me qira të mjediseve të përbashkëta, etj., përfshirë për efekte fiskale, si mbajtja e të ardhurave në burim). Ndërkohë që, duke e përcaktuar si subjekt jofitimprurës, asambleja nuk do të tatohet për të ardhurat e veta. Projektligji është përgatitur nga përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Zhvillimit Urban. Duke vlerësuar të domosdoshëm kontributin e të gjithë aktorëve, MZHU vë në dispozicion draftin e propozuar për të siguruar në këtë mënyrë një proces transparent dhe gjithëpërfshirës deri në draftin përfundimtar që do të miratohet.

Jeni të mirëpritur me komente dhe sugjerime, duke komunikuar së bashku në adresën e mëposhtme:
konsultime@zhvillimiurban.gov.al

Për tu njohur me draftin e plotë dhe relacionin, [Lexo më shumë.](#)